

## STATUTI

### I SHOQËRISË TREGTARE

#### "ORANGE FARMACI" SH.P.K.

Sot, më datë 21.11.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), ortakët:

1. **Shoqëria "Megapharma" sh.p.k**, subjekt juridik i së drejtës shqiptare, identifikuar me Nr.NIPT J61814028F, përfaqësuar nga administratori **Z.Robert Çina**, identifikuar me kartën e identitetit me Nr.028351459 dhe ne Personal F90314117B, me seli në adresën: Tiranë, : Rugav e Elbasanit, Mjulle Bathore, Nr.4, përballë TEG.
2. **Z.Arjan Hamitaj**, shtetas shqiptar, i biri i Hekuran i datëlindjes 02.11.1961, , identifikuar me karten e identitetit me nr. 025333811 dhe Nr.Personal G11102097D, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Z.Kushtrim Rudi**, shtetas shqiptarë, i biri i Sami i datëlindjes 16.12.1982, identifikuar me pasaportën pashaportës me nr.BB7835243 dhe Nr.Personal I21216063D, lindur në Kukës, banues në Tiranë person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
4. **Z.Denion Shengjergji**, shtetas shqiptare, i biri i Fatmir i datëlindjes 27.09.1977, identifikuar me kartën e identitetit nr.030502799 dhe Nr.Personal H70927151S, lindur në Durrës dhe banues Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
5. **Z.Stavrion Foto**, shtetas shqiptar, i biri i Vasil, i datëlindjes 09.06.1989, identifikuar me kartën e identitetit me Nrr.025133657,190609082O, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
6. **Z.Juxhin Palla**, shtetas shqiptarë, i biri i Vladimir, i datëlindjes 19.04.1986, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pashaportën me nr.BR4550620 dhe me Nr.Personal 90609082O.

Kanë vendosur themelimin e Shoqërisë "ORANGE FARMACI" SH.P.K. me terma si më poshtë:

#### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "ORANGE FARMACI" SH.P.K. rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

#### NENI 1.

##### Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë shtrihet në fushat e mëposhtme:

1



Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregtimi me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe paisjeve mjekësore, impianteve si dhe aksesorëve të tyre, si dhe të çdo lloj produkti tjetër që do të konsiderohet i dobishëm për aktivitetin e shoqërisë. Investime, shërbime, projekte në fushën e mjeksisë dhe shëndetit. Ngritja dhe menaxhimi i farmacive dhe klinikave private në fushën e mjeksisë etj.

Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barre hipotekore; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë. Të kryejë aktivitete publikimi, reklamimi, promocioni dhe sponsorizimi. Për më tepër, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga legjislacioni në fuqi. Shoqëria me qëllim investimin e kapitaleve të saj, mund të ketë interesa dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekte veprimtarie të çfarëdolloj natyre, të ngjashme apo që lidhen me aktivitetin e saj.

## **NENI 2.**

### **Emri dhe selia e Shoqërisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj "ORANGE FARMACI" SH.P.K.

Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga e Elbasanit, Mjulle Bathore, Nr.4, përballë TEG. Hapësira e përdorur në ushtrim të veprimtarisë së saj zë një sipërfaqe prej 10 m<sup>2</sup> dhe ndodhet në Katin e Tretë të godinës.

Adresa e faqes së Internetit të shoqërisë si dhe adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik do të pasqyrohen në rregjistrin menjëherë me fillimin e aktivitetit të tregtar të Shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë që me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hapë degë zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë.

## **NENI 3.**

### **Kohëzgjatja e Shoqërisë.**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe mund të ndryshohet një apo disa herë, sipas një vendimi të asamblesë së ortakëve.

## **NENI 4.**

### **Regjimi Juridik i Shoqërisë.**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.).

Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjisacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse ligjore. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## **II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.**

## NENI 5.

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë përveç për pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre që duhet të derdhen në kapitalin fillestar.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

## NENI 6.

### Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet me shtetin dhe për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të paautorizuar do ti shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruara deri në atë moment.

Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në nenin 1.

## NENI 7.

### Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dënimin për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

## NENI 8.

### Ndalimi i konkurrencës

Ortakët nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë. Gjithashtu, ata nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Ndalimi i përmendur më sipër mund të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga asambleja e përgjithshme me 51% të votave.

3

Ky autorizim mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie.

Nëse ndonjëri prej ortakëve shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:

- a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
- b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
- c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.

Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej ortakëve:

- a) të pranojë që transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
- b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
- c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.

#### NENI 9.

##### Largimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mbledhet apo nuk i njuh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Ortaku mund të largohet nga shoqëria me pëlqimin e ortakëve të tjerë. Në këtë rast ortakut që largohet nga shoqëria ka të drejtë të marrë rimbursimin e pjesmarrjes së tij në një përpjesëtim me pasurinë e shoqërisë. Ky i fundit përcaktohet nga administratorët bazuar në vlerën e tregut të saj në momentin e deklaratës së largimit (veçanërisht duke marrë në konsideratë gjendjen pasurore të shoqërisë, të ardhurave të saj, të vlerës së të mirave materiale, dhe jomateriale që ka në posedim, të gjendjes së saj në treg dhe të çdo rrethane dhe kushti tjetër që mbahet në konsideratë me qëllim përcaktimin e vlerës së pjesmarrjes në shoqëri). Rimbursimi i pjesmarrjes për të cilat është ushtruar e drejta e largimit duhet të zbatohet brenda 6 muajve nga njoftimi i ortakut shoqërisë.

#### NENI 10.

##### Përjashtimi i ortakut

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, apo nuk ka paguar kontributin si pasojë e një financimi, investimi, shtimi në kapital dhe detyrime të tjera të parashikuara në Statut apo nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e tij sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;

me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortakut ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortakut nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

### III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.

#### NENI 11.

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

#### NENI 12.

Kapitali fillestar i investuar nga Ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon Ortakëve dokumentin vërtetues për sasi të shumave të derdhura në fazën e themelimit.

#### NENI 13.

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 10.000 lekë i ndarë në 6 kuota.

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare "ORANGE FARMACI" Sh.p.k zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

1. Shoqëria "Megapharma" sh.p.k zotëron 1 kuotë me vlerë 7500 lekë (të reja) që i korrespondon 75% të kapitalit të shoqërisë.
2. Z.Arjan Hamiti zotëron 1 kuotë me vlerë 500 lekë (të reja) që i korrespondon 5% të kapitalit të shoqërisë.
3. Z.Kushtrim Rudi zotëron 1 kuotë me vlerë 500 lekë (të reja) që i korrespondon 5% të kapitalit të shoqërisë.

5



4. **Z. Denion Shengjergji** zotëron 1 kuotë me vlerë 500 lekë (të reja) që i korrespondon 5% të kapitalit të shoqërisë.
5. **Z. Stavriun Foto** zotëron 1 kuotë me vlerë 500 lekë (të reja) që i korrespondon 5% të kapitalit të shoqërisë.
6. **Z. Juxhin Palla**, zotëron 1 kuotë me vlerë 500 lekë (të reja) që i korrespondon 5% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali themeltar do të shlyhet totalisht në llogarinë bankare të Shoqërisë menjëherë pasi shoqëria të jetë regjistruar në Qendren Kombetare të Biznesit.

#### **NENI 14.** **Pronësia mbi kuotat.**

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

1. kontributit në kapitalin e shoqërisë;
2. shit-blerjes;
3. trashëgimisë;
4. dhurimit;
5. në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

#### **NENI 15.** **Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme për fitimin apo kalimin e kuotave.**

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në çdo rast, ortakët e shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, ndryshe janë të pavlefshme.

#### **NENI 16.**

Kuotat mund të anulohen në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anulimin e tyre.

Rastet e anulimit të kuotës do të përcaktohen nga rregullore të posaçme, të miratuara nga Asambleja e Ortakëve me 75 % të votave. Ndërsa likuidimi i saj do të bëhet sipas përcaktimeve të këtij statuti.

#### **NENI 17.** **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

6



**NENI 18.**  
**Fondet rezerve**

Shoqëria, vendos me shumice të thjeshte të votave në Asamblenë e Ortakëve, të krijojë fondin rezervor të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.  
Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

**NENI 19.**  
**Përdorimi i të ardhurave neto.**

E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.

**NENI 20.**  
**Bilanci, plani financiar.**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve në momentin e themelimit të Shoqërisë.  
Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.  
Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

**NENI 21.**  
**Shpërndarja e fitimeve**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

**NENI 22.**  
**Kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve**

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur,

pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

#### IV. ORGANET E SHOQËRISË.

##### NENI 23.

##### Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  e votave në rastet e mëposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve;
- raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti;

Për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë: miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

##### NENI 24.

Asambleja e Përgjithshme është e detyruar dhe me çdo kusht të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë.

Në rastet e parashikuara në pikën një dhe tre më sipër, përpara Asamblesë së Përgjithshme paraqitet një raport i përgatitur nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Në raste e parashikuara në pikën një dhe tre Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolute këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

8



#### NENI 25.

#### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 10 (dhjete) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### NENI 26.

#### Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

#### NENI 27.

#### Procesverbali i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

## NENI 28. Hetimet e posaçme

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit në të kundërt brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

Në rastet e vendimeve të parregullta të administratorit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë ti kërkojë Gjykatës kompetente shfuqizimin e këtyre vendimeve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit apo statutit.

Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme apo secili kreditor i shoqërisë mund ti kërkojë asamblesë së Përgjithshme shfuqizimin si më sipër, ose ata mund të proçedojnë vetë përpara gjykatës brenda 30 ditëve nga refuzimi i asamblesë për ngritjen e padisë. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brënda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

Proçedurat përpara gjykatës ndiqen nga një përfqësues i posaçëm i shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Kreditorët apo ortakët e sipërpërmendur kanë të drejtë të kërkojnë përpara gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit kur ka dyshime në lidhje me të për përfaqësimin e tij jo në interes të shoqërisë.

Rastet e hetimeve të posaçme dhe shfuqizimit të vendimeve të parregullta do të rregullohen sipas neneve 91 dhe 92 të ligjit " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

## V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

### NENI 29.

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve

10



prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Ortakët themelues shprehin pëlqimin për të zgjedhur administrator me mandat 1 vjeçar nga momenti i regjistrimit të shoqërisë, si me poshte vijon:

- **Z.Arjan Hamitaj**, shtetas shqiptarë, i biri i Hekuran i datëlindjes 02.11.1961, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit me Nr. 025333811 dhe me Nr. Personal

Shoqëria do të përfaqësohet përpara ç'do organi administrativ, gjyqësor, apo ç'do entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

### NENI 30.

#### Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- të thërrasë asamblesë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Në rast se Asambleja e Përgjithshme cakton më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### NENI 31

#### Shpërblimi i administratorëve

11  


Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

#### **NENI 32 Ekspertet kontabël**

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

#### **VI. MARRDHËNIET E PUNËS.**

##### **NENI 33**

Marrdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontrates individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

##### **NENI 34.**

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

#### **VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.**

##### **NENI 35.**

Kjo Shoqëri do të priset në rast kur:

- Kur përfundon kohëzgjatja e themelimit;
- hapen procedurat e falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

12  




- nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga Administratorët.

### **NENI 36.** **Likuidimi i shoqërisë**

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.

Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate.

Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.

Administratorët e shoqërisë i njoftojnë për regjistrim, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të dhënat e likuiduesve të parë dhe tagrat e tyre, për të përfaqësuar shoqërinë, së bashku me dokumentet përkatëse. Likuiduesit depozitojnë nënshkrimin e tyre. Likuiduesit i njoftojnë, gjithashtu, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim çdo ndryshim për identitetin dhe tagrat e tyre të përfaqësimit. Emërimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet *ex officio*, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me hapjen e procedurave të likuidimit, emri i regjistruar i shoqërisë ndiqet nga shënimi "në likuidim". Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët e shoqërisë për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj brenda 30 ditëve. Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

### **NENI 37.** **Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

13

The bottom of the page features several handwritten signatures in black ink. On the left, there is a large, stylized signature with the number '13' written above it. To its right is another signature, followed by a third signature that appears to be 'H. ...'. On the far right, there is a signature that looks like 'queto'.

**NENI 38.**  
**Bilancet**

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

**NENI 39.**  
**Shpërndarja e aktiveve**

Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakëve aktivet e mbetura, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, me përjashtim të rastit kur statuti parashikon radhë preference. Pasuritë, që i janë dhënë shoqërisë me qira apo në përdorim, me çfarëdo titulli u kthehen ortakëve apo aksionarëve. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

**NENI 40.**  
**Likuidimi i thjeshtëzuar**

Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet një procedurë të përsheptuar, nëse kjo vendoset nga të gjithë ortakët dhe kur këta deklarojnë përpara gjykatës përkatëse se të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj kreditorëve janë shlyer e janë rregulluar të gjitha marrëdhëniet me punëmarrësit. Administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", njoftojnë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit vendimin për likuidimin e shoqërisë, nëpërmjet procedurës së thjeshtëzuar. Administratorët janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga shkelja e detyrave të tyre gjatë likuidimit të thjeshtëzuar. Përveç administratorëve, ortakët apo aksionarët e shoqërisë përgjigjen në mënyrë solidare deri në shumat e marra.

**VII. DISPOZITA TË FUNDIT.**

**NENI 41.**

Ky Statut hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ortakët dhe regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 42.**

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 43.**

Ky Statut përpilohet në 8 kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

14



**NENI 44**


Ngarkohet Av. Endi Sinemati, me Nr. Liçense 5134, Nr. NIPT L717250160, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe/ose Xhensilda Likaj dhe/ose personat e autorizuar prej tij për depozitimin e këtij statuti, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve.

**ORTAKET THEMELUES**


1. Shoqëria "Megapharma" sh.p.k

Përfaqësuar nga administratori

Z. Robert Cina




2. Arjan Hamiti




3. Kushtrim Rudi



4. Denion Shengjergji



5. Stavrian Foto



6. Juxhin Palla

